



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 19.11.2024, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-1017/24-B, për zyrtarin Nexhip Sheholli, Specialist i Menaxhimit Financiar në Njësinë për Koordinimin e Projekteve të Huamarrjes nga Banka Botërore, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

## A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin Nexhip Sheholli, Specialist i Menaxhimit Financiar në Njësinë për Koordinimin e Projekteve të Huamarrjes nga Banka Botërore (në vijim: Specialist i Menaxhimit Financiar në NJKP), është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin të sipërpërmendur, ku theksohet se (citojmë nga kërkesa): “[...] ... a ka bazë për nisje të hetimeve nga AKK për një rast që përmes një hulumtimi së fundi e kemi publikuar në [...]. Bëhet fjalë për tre tendera të Ministrisë së Shëndetësisë ku pronari i dy kompanive përfituese dyshohet për konflikt interesi me [...] zyrtarë të lartë të Ministrisë Shëndetësisë [...]”.

Tutje në këtë raportim thuhet se: “[...]Nexhip Sheholli, zyrtar përgjegjës i një departamenti të MSH-së për menaxhimin e financave për projekte me Bankën Botërore, dyshohet se është përfshirë në një konflikt interesi me një kompani të huaj. Kompania irlandeze “KImego Consulting” L.L.C, e regjistruar në Kosovë si biznes më 24 mars të vitit 2023, ishte angazhuar edhe në të kaluarën nga Ministria e Shëndetësisë në disa projekte, në mesin e të cilave edhe në projektin për hartimin e Strategjisë së Sektorit të Shëndetësisë së Kosovës për vitet 2017 –



2021. Me rastin e regjistrimit si biznes në Kosovë, “Klmeo Consulting” L.L.C - në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), si kontabilist figuron zyrtari Nexhip Sheholli, i cili aktualisht është Specialist për menaxhimin e financave në Njësinë Koordinuese të Projektit të Bankës Botërore në MSH. [...] Nga dokumentet e siguruara përmes qasjes në dokumente publike për biznesin Klmeo Consulting L.L.C, shihet se regjistrimin e këtij biznesi në ARBK e ka kryer A. W. Kjo e fundit është pronare e kompanisë Klmeo Consulting në Irlandë, ku edhe ishte regjistruar fillimisht kjo kompani. Ndërsa punët për MSH-në në cilësinë e konsulentit, i kreu Th. W. i cili është babai i A. W. [...] Nexhip Sheholli, Specialist për menaxhimin e financave në Njësinë Koordinuese të Projektit të Bankës Botërore në MSH, kreu “shërbime të kontabilitetit” gjatë zbatimit të projektit për Klmeo Consulting L.L.C. Kjo dëshmohet edhe përmes një komunikimi të brendshëm me email-a zyrtar, ku Sheholli komunikon me Th. W. për ofrimin e shërbimeve të kontabilitetit për kompaninë Klmeo. Në një email të datës 6 korrik 2023, Sheholli e njofton konsulentin gjerman për shërbimet e kryera për Klmeo, e që ndërliqhen me shërbime të kontabilitetit në Administratën Tatimore të Kosovës. Shërbimet e kryera kanë të bëjnë pikërisht me projektin në të cilin W. ishte angazhuar nga MSH-ja.

Nga ajo që kuptohet përmes email-it, Sheholli del se është “ngarkuar” nga W. për ta bërë deklarin e TVSH-së për Klmeo Consulting. “Tanimë jam regjistruar në EDI – Deklarimin Elektronik në ATK, por nga kjo ATK supozon se ju më keni paguar për këto shërbime. ID-ja ime dhe emaili im shfaqen në sajt (ATK)”. Prandaj ATK do të më ngarkojë me një tarifë sepse askush nuk do ta besoj se këto shërbime jam duke i kryer falas”, thuhet në email-in e Shehollit, drejtuar W. Për t’u “pastruar” me ATK-në, Sheholli i kërkon atij që t’ia bëjë një transfer prej 200 euro në llogarinë personale. Në përgjigje, W. kërkon nga Sheholli llogarinë ku mund ta të regjistroj një kompani në Prishtinë. [...] Unë kam qenë i detyruar të paguaj TVSH-në për tarifën që kam marrë për shërbimet e mia. Autoritetet tatimore atje (Kosovë) pranonin vetëm pagesat e TVSH-së, kur paratë transferoheshin nga një llogari bankare e një banke në Kosovë. Duke qenë se nuk kam llogari bankare në Kosovë, kam shfrytëzuar shërbimet e z. Nexhip Sheholli, i cili është përgjegjës i “PIU World Bank” në emër të MSH-së. z. Nexhip Sheholli ma transferoi TVSH-në në organet tatimore. **Nuk kam asnjë marrëdhënie biznesi me [...] Nexhip Shehollin apo ndonjë qytetar tjetër të Kosovës”, thuhet në përgjigjet e kreut të Klmeo Consulting, Thomas Weismann [...].**

Ndërsa, Sheholli, përmes bisedës telefonike, ka thënë se nuk figuron si kontabilist i kësaj kompanie, por kur është pyetur për të dhënat e tij në ATK, ai ka shtuar se kjo ka ndodhur për shkak të faktit se kompania është regjistruar në objekt të Ministrisë së Shëndetësisë dhe se kontakti i tij figuron për shkak se ai (Th. W.), ‘nuk ka ditë me i plotësu format e aplikimit’. Ajo ka qenë e regjistruar në adresë të MSH-së. Nuk jam kontabilist, s’kam pagë, as kurgja. Nuk jam kontabilist i kompanisë. A jam themelues, a e keni vërejt? Jam vetëm person kontaktues; A shkrun dikund që jam kontabilist i saj? Jo..., Kjo ka qenë procedura pas marrjes së projektit, nuk është konflikt interesi aspak. Po të ishte marr tenderi para kësaj, e po të ishte emri im aty, nuk ka pas problem aspak. Ai ka ardh e ka kry projektin edhe ka shkue, u mbyll kontrata e tinaj. Biznesin e ka hapë vetëm për qat kontratë.”, ka thënë Sheholli. Por, Sheholli nuk ka sqaruar nëse është paguar me 200 euro për shërbimet e tij në llogarinë e tij private, siç është dëshmia e konfirmuar nga email-at zyrtar, duke e ndërprerë në gjysëm bisedën. Nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) kanë pranuar se të dhënat mbi regjistrimin e biznesit “Klmeo Consulting” në ARBK, janë transferuar në sistemin e ATK-së automatikisht me rastin



e regjistrimit si tatimpagues më 24 mars 2023, duke përfshirë këtu edhe numrat personal të dy zyrtarëve të Ministrisë së Shëndetësisë. “Sa i përket tatimpaguesit “KImego Consulting” L.L.C. [...], biznesi është i regjistruar me dt. 24.03.2023 dhe shënimet mbi regjistrimin e biznesit janë bartur në sistemin e ATK-së në mënyrë automatike nga ARBK dhe vazhdojnë të jenë si të tilla, [...]. Sipas informatave përmes VKME, tatimpaguesi (biznesi) ka kontaktuar fizikisht, zyrën e shërbimeve regjionale për qëllime të regjistrimit dhe pajisjes me Certifikatën e TVSH-së së fundi me dt.05.07.2023, e cila sipas procedurave tona tani figuron e anuluar dhe publikuar nga ATK në listën e tatimpaguesve joaktiv, përmes ueb faqes së ATK-së me dt. 14.03.2024. Po ashtu, është kontaktuar edhe nga qendra e thirrjeve për mos-deklarim, kanë thënë nga ATK. Në anën tjetër, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Kosovë, kompania KImego Consulting dhe eksperti gjerman Th. W., kanë qenë të angazhuar në dy projekte nga MSH-ja. Ato janë: “Asistencë teknike për të mbështetur vlerësimin e Strategjisë së Sektorit të Shëndetësisë së Kosovës 2017 – 2021; si dhe projekti për “Zhvillimin e një Vlerësimi Kombëtar të Shëndetit Mendor”. [...] Në fund, sipas MSH-së, për angazhimin e kësaj kompanie me MSH-në janë ndjekur procedurat e prokurimit të Bankës Botërore, të udhëhequra nga Njësia Koordinuese e Projektit në fjalë” (përfundon citimi i raportuesit të rastit).

Konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia përmes shkresës zyrtare e ka njoftuar zyrtarin Nexhip Sheholli, lidhur me fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të këtij rasti është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin Nexhip Sheholli, me ç’rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit si dhe me informatat që posedon Agjencia lidhur me këtë rast.

Në takim, zyrtari i lartë ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë, duke theksuar se: ‘*asnjëherë nuk kam marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes për dhënie të kontratës dhe në asnjë proces tjetër deri në momentin që kam inicuar kërkesë për pagesë. Pastaj, unë nuk kam as një aksion, lidhje direkte apo indirekte dhe ndonjë lidhje familjare me “KImego Consulting” L.L.C, me pronare A. W., njëherit konsulente e cila ka të angazhuar Th. W., që kanë konkurruar për një tender ndërkombëtarë për shërbime profesionale sipas procedurave të prokurimit të Bankës Botërore*’.

Tutje, në takim zyrtari Nexhip Sheholli sqaron në hollësi të gjithë procesin dhe ecurinë e këtij tenderimi, duke shtuar se, ‘*të gjitha deklaratat e mia, do t’ia paraqes Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit edhe në formë të shkruar*’.

Në takim, zyrtari Nexhip Sheholli ka deponuar edhe dokumentacion relevant lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit, një deklaratë si dhe dokumentacion në mbështetje të qëndrimeve të tij të shprehura në takim, ndërsa, në kompletim të dokumentacionit dhe sqarimit të mëtejshëm të rastit në fjalë, Agjencia ka mbledhur informacion dhe ka bërë verifikimet e nevojshme të tyre në institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Në deklaratën me shkrim të zyrtarit Nexhip Sheholli, (përfshirë dokumentacionin në mbështetje të deklaratës së tij), të deponuar në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, theksohet se (citojmë):

*“Unë Nexhip Sheholli, i punësuar si shërbyes civil në Cilësinë e Konsulentit-Specialist i Menaxhimit Financiar në Njësinë për Koordinimin e Projekteve të Huamarrjes nga Banka*



Botërore - Projekti Emergjencia Covid-19 për Kosovën dhe Financimi shtesë gjate periudhës 2021-2024. Personalisht deklaroj se as një here nuk kam marre pjese ne procesin e vendimmarrjes për dhënie te kontratës dhe ne as një proces tjetër deri ne momentin qe kam inicuar kërkesën për pagese. Unë nuk kam as një aksion, lidhje direkte apo indirekte dhe as lidhje familjare me "Kimego Consulting" L.L.C, me pronare A. W. e cila si konsulent ka te angazhuar Th. W. qe ka konkurruar për një tender ndërkombëtarë për shërbime profesionale sipas procedurave te prokurimit te Bankës Botërore: [...]. Vlera e kontratës ka qene [...] €, dhe pas plotësimit te kushteve te kërkuara ne tender "Kimego Consulting" LLC nga komisioni vlerësues i tenderit është shpërblyer me kontrate. Operatori ekonomik "Kimego Consulting" LLC i ka kryer te gjitha shërbimet profesionale për klientin - MSh dhe menaxheri i kontratës ka rekomanduar për pagese te shërbimeve profesionale sipas faturave te dërguara nga operatori ekonomik. Unë e kam përgatitur dokumentacioni për pagese te faturave, pastaj dokumentacioni përcillet ne shërbimin financiar te MSh duke iu nënshtruar Kontrollit te brendshëm ku zyrtaret financiar përfshijnë mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë, zyrtarin kryesor administrativ, zyrtarin kryesor financiar, zyrtarin e prokurimit dhe zyrtarin e certifikimit.[...] Raportuesi i rastit (v.j) i drejtohet Ekspertit gjerman Th. W., lidhur me pretendimet e tij. Inspektori tatimor i ATK z. A. H., me kontakton në telefon mua dhe me thotë se, z. Th. W., ka leshur një fature tatimore pa qenë fare i regjistruar në TVSh, ju lutem a keni mundësi të siguronit numrin e telefonit të tij që të kontaktoj dhe ta këshillojmë për procedurat tatimore që duhet ndërmarr z. Th. W. (forma për vizitën përmbledhëse nga ATK). [...]. Operatori ekonomik "Kimego Consulting" LLC është njoftuar se është obligues i TVSH, dhe ka kërkuar përkrahje nga ana ime qe te perkrahu ne nxjerrjen e Certifikatës se TVSH, ku kemi qene se bashku ne ATK e ka bere kërkesën për certifikatë te TVSh dhe ATK pas disa dite e ka njoftuar Konsulentin Th. W. se Certifikata e TVSH është e gatshme dhe mund te vini për tërheqje te Certifikatës se TVSH. Pas tërheqjes se Certifikatës se TVSh "Kimego Consulting" LLC, konsulenti Th. W. është përpjekur qe te beje pagesën e TVSh ne arkën shtetërore, por ka qene e pamundur realizimi i pagesës nga ana e tij sepse nuk ka pasur te hapur llogari bankare ne bankat komerciale ne Kosove dhe nuk ka mundur qe te regjistrohet ne Sistemin EDI. Me ka thirr ne telefon dhe me ka informuar se nuk po mundem qe te marr veprimet e rekomanduara nga ana e juaj. Konsulenti Th. W., me ka lutur për asistencë teknike dhe kemi shkuar prape s'bashku ne ATK qe te regjistrohet ne Sistemin EDI për deklarim dhe pagese te TVSh, por ka qene e pamundur për arsye se Sistemi EDI nuk e njej numrin personal te shtetasit te huaj, kështu qe i kam thënë duhet ta gjejsh një agjent reprezentativ qe te merret me ketë çështje sepse Sistemi EDI është standard për te gjithë dhe ne një dritare te sistemit te EDI shkruan Kontabilisti nëse unë e vendosi emrin tim aty shfaqet se Kontabilisti i "Kimego Consulting" LLC, figuron emri im Nexhip Sheholli por ne asnjë mënyrë si kontabilist i "Kimego Consulting" L.L.C. Ne momentin qe është vendosur emri im atëherë kemi mundur qe te përgatisim dhe deklarojmë TVSH, dhe ne afate ligjor e ka paguar TVSH ne vlere prej: 3,394.12 € me datën 19.07.2023, ku shihet nga fletëpagesa e bashkangjitur.

Ndërsa, në reagimin e Ministrisë së Shëndetësisë ndaj lajmit publik në media të caktuara për dyshime rreth konfliktit të interesit të zyrtarëve të MSH-së me rastin e dhënies së disa tenderëve, ndër të tjera theksohet se (citojmë): "Ministria e Shëndetësisë reagon ndaj lajmit me titull "Dyshimet për konflikt interesi në MSH: [...], Specialisti i Menaxhimit Financiar në Njësinë Koordinuese të Projektit, Z. Sheholli, nuk është pjesëmarrës në vendimmarrje, por vetëm ka ofruar asistencë teknike për deklarimin dhe pagesën e TVSh-së që në sistemin EDI të ATK-së nuk lejohet të bëhet deklarimi pa e cekur zyrtarin i cili deklaroi obligimet tatimore. Kështu që, konsulentit i është dhënë asistencë nga Projekti i Bankës Botërore që ai të kryej



*obligime ndaj shtetit siç obligohet nga dispozitat ligjore të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, informojmë publikun se eksperti gjerman është kontraktuar sipas procedurave të prokurimit të Bankës Botërore dhe është përzgjedhur në bazë të kriterëve të vlerësimit nga Komisioni për vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik dhe jo siç pretendohet në artikullin e gazetës online [...]”.*

Agjencia ka analizuar me kujdes pretendimet e raportuesit të rastit për konflikt të mundshëm të interesit si dhe deponimet tjera të ndërlidhura me këtë rast, deklaratat, sqarimet e palës dhe dokumentacionin e siguruar sipas kërkesës së Agjencisë, si dhe provat tjera të siguruara sipas detyrës zyrtare, dhe më pas ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Me datë 25.11.2020, Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës (për klientin: e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i MSH-së - A. M.) dhe “KIMEGO Consulting” Ltd (për konsulentin: e nënshkruar nga Th. W., -ekzekutues i marrëveshjes, për aprovim: nënshkruar nga A. W., - Drejtor i “KIMEGO Consulting” Ltd ), lidhin kontratë për shërbime të konsulencës me Nr. 2.5.2, P147..., me titull: “Asistencë teknike për të mbështetur vlerësimin e Strategjisë së Sektorit të Shëndetësisë së Kosovës 2017 - 2021”;

Me datë 24.02.2023, Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës (për dhe në emër të Ministrisë së Shëndetësisë e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i MSH-së), dhe “KIMEGO Consulting” Ltd (për dhe në emër të “KIMEGO Consulting” Ltd, e nënshkruar nga Th. W.), lidhin kontratën për shërbime të konsulencës me nr. XK.-MOH-314...-CS..., me titull: “Zhvillimin e një Vlerësimi Kombëtar të Shëndetit Mendor”

Me datë 24.03.2023, ARBK ka lëshuar certifikatë biznesi me Numër Unik Identifikues 812027771, për “KImego Consulting”<sup>1</sup> L.L.C., Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara, me pronare dhe përfaqësuese të autorizuar A. W., adresë: Str. Zagrebit pn.;

Në përgjigjen (email-in) e Th. W., dërguar (për informacion) zyrtarit të MSH-së Nexhip Sheholli, lidhur me pretendimet e raportuesit të rastit se, “i njëjti ka kryer shërbime të kontabilitetit gjatë zbatimit të projektit për “KImego Consulting” L.L.C., mes tjerash Th.W. thekson se; “Unë kam qenë i obliguar të paguaj TVSH-në për tarifën e pranuar për shërbimet e mia. Autoritetet tatimore pranonin vetëm pagesat e TVSH-së, kur paratë transferoheshin nga një llogari bankare e Kosovë. Meqë nuk kam llogari bankare në Kosovë, kam shfrytëzuar shërbimet e z. Nexhip Sheholli, i cili është përgjegjës i “PIU World Bank”, në emër (interes) të MSH-së. z. Nexhip Sheholli transferoi TVSH-në për mua në organet tatimore. Nuk kam asnjë marrëdhënie biznesi me [...] Nexhip Shehollin apo ndonjë qytetar tjetër të Kosovës”, thuhet në përgjigjet e kreut të KImego Consulting, Th. W. [...]”.

Nga informacioni dhe dokumentacioni relevant i siguruar nga MSH, historiku dhe informatat mbi bizneset të siguruara nga ARBK, si dhe informacione/dokumentacione tjera të siguruara nga institucione tjera relevante, Agjencia nuk ka gjetur se, zyrtari Nexhip Sheholli, Specialist i Menaxhimit Financiar në Njësinë për Koordinimin e Projekteve të Huamarrjes nga Banka Botërore, të ketë (pasur) ndonjë vendimmarrje apo çaste paraprake të vendimmarrjes gjatë procesit të dhënies së kontratës në fjalë, sikurse nuk është gjetur që i njëjti të ketë pasur ndonjë funksion në biznesin “KImego Consulting” L.L.C., e as nuk rezulton se ndërmjet këtij biznesi

<sup>1</sup> Sipas Th. W., kompania në fjalë hapet në Kosovë me qëllim të ofrimit të shërbimeve të kontraktuara për MSH-në;



dhe zyrtarit në fjalë të ketë (pasur) marrëdhënie biznesore, apo çfarëdo afërsie tjetër në kuptim të dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Pas konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia konstatoi se, nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit për zyrtarin Nexhip Sheholli, Specialist i Menaxhimit Financiar në Njësinë për Koordinimin e Projekteve të Huamarrjes nga Banka Botërore.

Kësisoj, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

*"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".*

Lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

*"Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste",*

si dhe me nën-paragrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

*"person i afërm me zyrtarin është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës."*

Ndërsa, dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definojnë nocionin vendimmarrje si:

*"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."*

Pra, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes, nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit apo të personave të afërm me të, në një çështje të caktuar. Për tu konstatuar konflikti i interesit në një çështje të caktuar, duhet të plotësohen kushtet thelbësore (kumulative) të tij, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes si dhe interesi privat i zyrtarit ose i personave të afërm me zyrtarin.

Në rastin konkret, përveç që nuk është konstatuar se ka pasur vendimmarrje e as çaste paraprake të vendimmarrjes në procesin e dhënies së kontratës së sipërpërmendur, nuk është gjetur gjithashtu se zyrtari në fjalë ka (pasur) interes privat për vete apo personat e afërm me të, në çështjen në fjalë, pasi që i njëjti nuk ka asnjë funksion në biznesin "KImego Consulting"



L.L.C., nuk rezulton se ndërmjet këtij subjekti (biznesi) dhe zyrtarit të lartë në fjalë ka (pasur) marrëdhënie biznesi e as subjekti privat në fjalë nuk është person i afërm juridik me të, në kuptim të dispozitave të sipërcituara të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.


Prandaj, në mungesë të rolit *vendimmarrës* të zyrtarit Nexhip Sheholli në procesin e dhënies së kontratës së sipërcekur, e gjithashtu në mungesë të plotësimit edhe të kushtit tjetër kumulativ-*interesit privat të zyrtarit apo të personave të afërm me të*, në rastin konkret përjashtohet konflikti i interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Agjencia e ka trajtuar çështjen e *'ofrimit të asistencës teknike nga zyrtari Nexhip Sheholli, Specialist i Menaxhimit Financiar në Njësinë për Koordinimin e Projekteve të Huamarrjes nga Banka Botërore, dhënë konsulentit Th. W., për deklarimin dhe pagesën e TVSh-së në sistemin EDI të ATK-së*, vetëm nga aspekti i konfliktit të interesit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, dhe nuk është lëshuar në shqyrtimin e ligjshmërisë/arsyeshmërisë ose jo të çështjes në fjalë, pasi që këto aspekt nuk hynë në sferën e konfliktit të interesit sipas legjislacionit përkatës të Agjencisë.

**II.** Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [*Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit*], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: *"Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë."*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *"Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative."*

Nga sa u tha më lartë, duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

Yll BULESHKAJ  
  
Drejtor i Agjencisë për  
Parandalimin e Korrupsionit

- Zyrtarit publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës të lëndës)